



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 34, datë 11.08.2022

**PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATURËS SË ZNJ. HOLTA ZAÇAJ
NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, TË
SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË NË DATË 21.02.2019, DATË 19.04.2019,
DATË 03.06.2021 DHE DATË 15.11.2021**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Binaj	Kryetar
Marsida Xhaferllari	Zëvendëskryetare
Anila Leka	Anëtare relatore
Elsa Toska	Anëtare
Edlira Petri	Anëtare
Enton Dhimitri	Anëtar
Genti Xholi	Anëtar zëvendësues
Etien Kapo	Anëtar
Klodiana Mema	Anëtare

Asistuar nga sekretare Fabjola Muhameti.

Me praninë e Z. Enio Haxhimihali, përfaqësues i autorizuar i Avokatit të Popullit, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mbledhjen e datës 10.08.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Holta Zaçaj

OBJEKTI: Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidaturës së Znj. Holta Zaçaj, në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe datë 15.11.2021.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), Znj. Anila Leka, mendimin e paraqitur nga përfaqësuesi i Avokati i Popullit, në cilësinë e vëzhguesit të përhershëm në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr. 14, datë 20.07.2022 ka vendosur *“Lejimin e kandidimit të kandidatës Holta Zaçaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021”*. Për rrjedhojë, në bazë të pikës 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, pikave 2 dhe 3 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”*, nenit 228 pika 5, nenit 239 dhe 240 të Ligjit nr. 155/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”* dhe pikave 36 e 38 të Vendimit nr. 5, datë 02.04.2019, *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, relatorja Anila Leka, duke u bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, hartoi relacionin e vlerësimit të kësaj kandidateje për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

2. Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8577/2000 dhe të ligjit nr. 115/2016, si edhe atyre të Kreut IV (pikat 27-38) të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, *“Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, anëtarja e Këshillit, znj. Anila Leka, në cilësinë e relatorit të vendit vakant të cituar më lart, ka realizuar veprimet përgatitore të procedurës së vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, njëkohësisht me procedurat e verifikimit të tyre.

3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi procedurat e ndjekura gjatë veprimeve përgatitore nga secili relator dhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga secili kandidat, dëgjoi mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për përgatitjen e dokumentacionit të kandidatëve, me vendimin e datës 03.08.2022 ka vendosur fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe rishpallur në datë 15.11.2021.

4. Bazuar në aktet që janë dorëzuar nga kandidatja Holta Zaçaj në momentin e kandidimit dhe gjatë fazës përgatitore të procedurës së vlerësimit, anëtarja e Këshillit, relatore e vendit vakant në të cilën ky kandidat ka paraqitur kandidaturën e tij, hartoi relacionin përkatës për gjetjet në procedurën e përzgjedhjes dhe të vlerësimit të kësaj kandidateje për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, i cili i është njoftuar kandidatit.

5. Kryetari i Këshillit ka thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 10.08.2022, ora 10:00, për zhvillimin e intervistës dhe testimin e njohurive të gjuhës së huaj me kandidatët e lejuar. Pas përzgjedhjes nga kandidatja Holta Zaçaj të gjuhës së huaj “angleze”, për qëllime të intervistimit, Kryetari i Këshillit ka thirrur mbledhjen e Këshillit në datën 10.08.2020, ora 10:00, duke siguruar pjesëmarrjen e znj. Etleva Kondi, Pedagoge e Gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, pranë Universitetit të Tiranës, në cilësinë e ekspertes së gjuhës së huaj “angleze”.

6. Intervista mbi motivimin e kandidimit dhe nivelin e zotërimit të gjuhës së huaj me kandidaten Holta Zaçaj u zhvillua në mbledhjen e Këshillit të datës 10.08.2022.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

7. Në përfundim të intervistës, bazuar në të dhënat e nxjerra nga biseda mbi motivimin e kandidimit, mendimin e ekspertës për nivelin e zotërimit të gjuhëve të huaja, si edhe bazuar në aktet dhe dokumentet që janë dorëzuar nga kandidatja Holta Zaçaj në momentin e paraqitjes së kërkesës për kandidim, dokumente të paraqitura prej saj sipas kërkesave të Këshillit, si edhe shkresa dhe të dhëna të tjera të kërkuara apo të ardhura zyrtarisht nga institucione të ndryshme, Këshilli ka biseduar mbi vlerësimin dhe pikëzimin e kandidates Holta Zaçaj për secilin nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara:

- a) në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës;
- b) në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të plotësuar, për aq sa nuk përcaktohet ndryshe në këto dispozita, me kriteret e përgjithshme të vlerësimit të parashikuara në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016;
- c) në detajimin e mëtejshëm të kriterëve ligjore të posaçme dhe të përgjithshme të vlerësimit dhe përcaktimit më të hollësishëm të peshës specifike të tyre në pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të treguar në Kreun II, në Kreun V dhe në Shtojcën 1 të Vendimit nr. 5 datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”;
- ç) në shpjegimet e hollësishme lidhur me metodologjinë mbi të cilin bazohet në vlerësimi dhe caktimi i pikëve të miratuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”.

A. Meritat profesionale – Historiku Arsimor dhe Profesional

Vjetërsia në profesion

8. Në shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi “Vjetërsia në profesion”. Ndërkohë që, sipas nenit 125 të Kushtetutës dhe nenit 7/a pika 2 shkronja “a” të ligjit nr. 8577/2000, përbën kusht lejimi kandidimi që kandidati të ketë së paku 15 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës (jurist) i nivelit të lartë në administratën publike.

9. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë kohëzgjatjen për më shumë se 15 vjet të këtyre fushave të përvojës profesionale të secilit kandidat, në maksimum deri në 4 pikë, sikurse orientohet në tabelën e përshkallëzuar të pikëzimit të vjetërsisë në profesion të treguar në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

10. Sipas jetëshkrimit rezulton që kandidatja Holta Zaçaj, ka ushtruar veprimtaritë profesionale si më poshtë:

Avokate, për periudhën Janar 2020 e në vijim, pranë Zyrës së Avokatisë “Zaçaj Laë PC”. Anëtare e Komitetit për Shërbimet e Mbrojtësit Publik – Divizioni për fëmijët dhe familjen në shtetin e Massachusetts, SHBA.

b) Avokate, për periudhën Maj 2019 – Janar 2020, pranë Ligris and Associates PC, SHBA.

- c) *Drejtores e Departamentit të Shërbimeve Ligjore, për periudhën Maj 2013 Tetor 2018, pranë Alpha Bank Albania SHA. Përgjegjësitë e kryera: konsulente ligjore pranë Bordit të Drejtorëve, mbrojtja e interesave të Bankës (avokat i bankës), përgjegjës për hartimin e të gjitha kontratave të bankës.*
- c) *Avokat/Partner, për periudhën Korrik 2008 – Prill 2013 dhe Janar 2019 e në vazhdim, pranë “Delegibus Consulting”, firmë ligjore.*
- d) *Pedagoge e jashtme/specialiste, Viti akademik 2009-2013, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- dh) *Trajnues, Viti akademik 2010-2011, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- e) *Trajnues, Viti akademik 2009-2010, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- ë) *Trajnues, Viti akademik 2008-2009, pranë Shkollës së Magjistraturës.*
- f) *Pedagoge me kohë të pjesshme, Viti akademik 2013-2014, pranë Universitetit Luarasi.*
- g) *Pedagoge e jashtme, Viti akademik 2009-2010, pranë Universitetit Europian të Tiranës.*
- gj) *Avokate/Drejtores ekzekutive, Gusht 2002 – Maj 2007, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara (QSHPLI).*
- h) *Bashkëdrejtores, 1999-2002, pranë Qendrës Paqe nëpërmjet Drejtësisë (Kandidatja referon se subjekti është mbyllur, nuk është më aktiv).*

11. Mbështetur në të dhënat e sipërcituara, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj, në momentin e përpilimit të relacionit të vlerësimit (datë 02.08.2022), referuar dhe shkresës nr. 192 prot., datë 8.4.2022, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, ka gjithsej *17 vjet e 7 muaj e 2 ditë* vjetërsi në profesion si avokate, ndër të cilët dhe si avokate për dhënie e ndihmës falas për grupet vulnerabel dhe përvojë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndërsa veprimtaritë e tjera profesionale si pedagoge me kohë të pjesshme, trajnuese dhe angazhime të tjera profesionale, janë kryer nga kandidatja në të njëjtën periudhë kalendarike, ose të mëhershme me atë të përvojës së punës në pozicionet e lartpërmendura sipas përcaktimeve të nenit 125, të Kushtetutës dhe nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. (Referuar momentit të kandidimit, datë 21.12.2021, kandidatja ka rreth *16 vjet e 355 ditë* vjetërsi në profesion.

12. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit “vjetërsia në profesion”, nisur nga ushtrimi i veprimtarive profesionale në një kohëzgjatje prej *16 vjet e 355 ditë*, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Holta Zaçaj me **1 (një) pikë**.

Historiku Arsimor

13. Në shkronjën “d” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, përcaktohet si kriter vlerësimi edhe ecuria gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, ndërkohë që edhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 kërkon të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve në ciklet e arsimit të lartë.

14. Prandaj, Këshilli vlerëson me pikë ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë me një notë mesatare jo më pak se 8 ose të barasvlefshme me të, të secilit kandidat, sipas përshkallëzimit me 1 pikë të notës mesatare mbi 8 dhe me 2 pikë të notës mesatare mbi 9, sikurse orientohet në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

15. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidatës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton që kandidatja Holta Zaçaj ka përfunduar studimet dhe është diplomuar në vitin 1998 si jurist, në

Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

16. Në bazë të certifikatës së notave të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës rezulton se kandidatja ka mbrojtur diplomën me notën 10 dhe me notë mesatare të lëndëve të detyrueshme rreth 9,5.

17. Për sa më lart, nisur nga përlogaritja e kryer nga Këshilli sipas të cilës rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka mbrojtur diplomën me notën 10 dhe me notë mesatare të lëndëve të detyrueshme rreth 9,5, për kriterin e vlerësimit "*historiku arsimor*", Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidatin me **2 (dy) pikë**.

Kualifikime Pasuniversitare

18. Në pikën 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe pikat 1 e 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi kualifikimet pasuniversitare. Ky kriter vlerëson llojin dhe nivelin e angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të madh në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrimeve profesionale të tilla si, pasja e titujve akademikë, gradave shkencore, ecuria dhe kryerja e kualifikimeve pasuniversitare, studimeve dhe specializimeve afatgjata (përfshirë Shkollën e Magjistraturës), si edhe kryerja e trajnimeve afatgjata dhe afatshkurtra në fushën e të drejtave kushtetuese, të drejtave të njeriut, si edhe në fusha të tjera të së drejtës.

19. Referuar kriterëve ligjore të vlerësimit dhe metodologjisë së pikëzimit, që gjejnë pasqyrim në mënyrë të detajuar në Shtojcën nr. 1 të vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kualifikimeve pasuniversitare, si një nga indikatorët me të cilët vlerësohet niveli profesional i kandidatëve, u janë caktuar në total 8 pikë.

20. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin e titujve akademikë dhe gradave shkencore, llojin, kohëzgjatjen, fushën dhe vendin e kryerjes së kualifikimeve pasuniversitare, studimeve, specializimeve dhe trajnimeve të kandidatëve, duke pasur parasysh shpërndarjen e pikëve sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

21. Sipas jetëshkrimit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës dhe në kuadër të veprimeve përgatitore të procedurës së vlerësimit, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj ka ndjekur studimet "*Master i Ligjeve*" (LL.M) në Universitetin Georgetown Washington D.C., periudha Shtator 2007-Maj 2008, Student Fulbright. Për këtë cikël studimi është paraqitur diploma e njësuar me origjinalin dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, për të cilën kandidatja nuk ka kërkuar njohjen e titullit të studimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

22. Për këto arsye, për kriterin e vlerësimit Tituj, grada, shkolla e magjistraturës etj., Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Holta Zaçaj, me **0,55 (zero presje pesëdhjetë e pesë) pikë**.

23. Për treguesin e vlerësimit "*Trajnimet e tjera*", vlerësohen veçanërisht trajnime me një kohëzgjatje minimale 2 javore, duke mbajtur parasysh edhe numrin, llojet, tematikat dhe

kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, si dhe nëse trajnimet janë shoqëruar me një certifikatë vlerësimi. Lidhur me këtë kriter vlerësimi. Këshilli mund të caktojë deri në 2 pikë.

24. Nga kandidatja është paraqitur dokumentacion mbështetës, kopje e njësuar me origjinalin, për kualifikimet/trajnimet e mëposhtme:

- Kualifikim: Kualifikim për bazat e legjislacionit amerikan dhe edukimit ligjor
Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Georgetown, Washington DC, USA
Periudha: 8 Korrik-4 Gusht 2007
- Trajnim: Tema "Ligji për refugjatët dhe Praktika"
Institucioni: UNHCR
Periudha: 26-28 Korrik 2001
Praktikë/interbship: Praktikë në Gjykatën e Shkallës së Parë në Paris
Periudha: 26 Mars-25 Maj 2001
- Trajnim: Mbi teknikat e hartimit të legjislacionit
Institucioni: ORT/USAID
Periudha: Shkurt-Mars 1999
- Trajnim: Databaza e Klinikës Ligjore (i papërmendur në jetëshkrim)
Institucioni: World Learning
Periudha: 5-10 Shkurt 2001

Për kualifikimin vijues është paraqitur nga kandidatja kopje jozyrtare:

- Kualifikim: Në të drejtën kushtetuese
Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Suffolk, Massachusetts, USA
Periudha: Janar-Maj 2018

Gjithashtu, nga kandidatja është deklaruar në jetëshkrim pjesëmarrja në trajnimet vijuese, pa u paraqitur dokumentacion provues:

- Trajnim: Kurs trajnimi për demokraci dhe zhvillim
Institucioni: Fakulteti i Drejtësisë, Stanford, California, USA
Periudha: Korrik-Gusht 2006
- Trajnim: Për menaxhimin e programeve të klinikave ligjore
Institucioni: Komiteti Hungarez i Helsinkit
Periudha: Shtator 2003-Dhjetor 2004
- Trajnim: Për qasjen pedagogjike të trajnerëve të profesionistëve të nivelit të lartë në Shkollën e Magjistraturës, Shqipëri
Institucioni: Këshilli i Evropës
Periudha: Mars-Prill 2003
- Trajnim: Programi i vizitorëve ndërkombëtarë në Departamentin e Shtetit, USA
Periudha: Qershor-Korrik 2002
- Trajnim: Mbi të Drejtat e Njeriut
Institucioni: Komiteti Hollandez i Helsinkit dhe Ministria e Punëve të Jashtme Hollandeze, Utrecht, Hollandë
Periudha: 5 Qershor-17 Korrik 1999

25. Sa më sipër, mbështetur në të dhënat e jetëshkrimit të kandidatit dhe dokumentacionit të administruar në procedurën e verifikimit të kandidaturës, si dhe duke pasur parasysh numrin, llojin, kohëzgjatjen dhe tematikat e veprimtarive trajnuese të ndjekura nga kandidatja Holta Zaçaj, për këtë kriter ligjor vlerësimi Këshilli çmoi ta vlerësojë me **1,77 (një presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.

Njohja e gjuhëve të huaja

26. Në shkronjën “c” të pikës 4 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, përcaktohet si kriter vlerësimi niveli i zotërimit të gjuhëve të huaja.

27. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë llojin dhe numrin e gjuhëve të huaja, si edhe nivelin e zotërimit të tyre nga ana e kandidatëve, duke pasur parasysh sasinë e pikëve maksimale përkatëse sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019, të këtij Këshilli, si edhe orientimet që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

28. Nga kandidatja është paraqitur raporti i rezultatit të Kandidatit të Testit me bazë Interneti për testin e anglishtes si gjuhë e huaj TOEFL, me vlerësimin Lexim - 26. Dëgjim- 28. E folur- 26 dhe Shkrim- 25, Total- 105. Gjithashtu, ka paraqitur dëftesë pjekurie të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Gjuhëve të Huaja “Asim Vokshi”, në të cilën, ndër të tjera, rezulton kryerja e lëndëve gjuhë “angleze” vlerësuar me notën përfundimtare 10 në vitin e dytë; gjuhë “frënge” vlerësuar me notën përfundimtare 10 në secilin prej katër vitet e shkollës së mesme; gjuhë “gjermane” vlerësuar me notën 10 në vitin e parë, të dytë dhe të tretë dhe me notën 9 në vitin e katërt të shkollës së mesme. Gjithashtu, në provimin e pjekurisë është vlerësuar me notën 9 në gjuhën gjermane.

29. Në Metodologjinë e Vlerësimit dhe Caktimit të Pikëve lidhur me këtë kriter vlerësimi citohet ndër të tjera se, për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur Këshilli e vlerëson të nevojshme, do të caktojë ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit/es mund të vlerësohet deri në 3 pikë. Gjithashtu, Këshilli mban parasysh edhe zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara për të cilat kandidati/ja nuk testohet gjatë intervistës, me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Në këtë rast, krahas vlerësimit konkret me pikë për gjuhën e huaj të zgjedhur prej tij/saj për pikëzim, kandidatit/es mund t’i shtohet 1 pikë.

30. Në mbledhjen e datës 10.08.2022 kandidatja Holta Zaçaj u intervistua në gjuhën angleze dhe Këshilli administroi mendimin e ekspertes së gjuhës, znj. Etleva Kondi, e cila dha vlerësimin për këtë kandidat me 3 (tre) pikë.

31. Këshilli, si konsideroi mendimin e ekspertes së gjuhës së huaj, vlerësoi të dhënat që përmban dosja e kandidimit nga ku rezulton se kandidatja ka paraqitur dokument vlerësues të vlefshëm për aftësitë e saj gjuhësore në gjuhët e tjera të huaja “italiane”, “gjermane” dhe “franceze”, çmtoi ta vlerësojë kandidaten Holta Zaçaj për këtë kriter ligjor vlerësimi, në total me **4 (katër) pikë**.

B. Meritat profesionale – Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional

32. Në shkronjën “ç” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e përgjithshëm profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi, në bazë të treguesve shkencorë, performanca e dalluar dhe rezultatet e larta në ushtrimin e profesionit, që

mbështetet ndërmjet të tjerave në botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike, në produktet profesionale sipas profileve të ushtrimit të profesionit, rezultatet e vlerësimit profesional dhe të etikës të kandidatëve në punët që kanë bërë në të shkuarën, nëse ka, ose rezultatet e dallueshme të arritura gjatë përvojave të tyre të punës e që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën përkatëse.

33. Prandaj, në zbatim të ligjit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson me pikë si sasinë ashtu edhe cilësinë e rezultateve profesionale, me një fokus të veçantë tek cilësia. Në këtë mënyrë, bazuar në të dhënat e mundshme të disponueshme për vlerësim, mbahen parasysh sasia e pikëve maksimale prej 30 pikësh, sipas vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të KED, si edhe orientimet për caktimin e mundshëm të një maksimumi prej 25 pikësh për sa i përket vlerësimit cilësor dhe të një maksimum prej 5 pikësh për vlerësimin e sasisë së rezultateve profesionale sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

34. Në rastin e kandidates Holta Zaçaj, Këshilli shqyrtoi dokumente profesionale dhe të dhënat që mund të disponoheshin nga veprimtaria e tij profesionale, si edhe nga kontributet e tjera profesionale të kësaj kandidateje në veprimtari të ndryshme, përfshirë publikime apo punime e artikuj shkencorë.

35. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezultojn se kandidatja Holta Zaçaj ka dorëzuar më datë 25.07.2022 punimet profesionale si më poshtë vijon:

- Manual mbi zbatimin e Kodit të Familjes dhe legjislacionit civil në lidhje me çështjet për të miturit;
- Raporti Alternativ i Konventës së OKB për të Drejtat e Fëmijëve;
- Manual “Intervistimi i të Miturve nga Punonjësit e Policisë”;
- Hartëzimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës;
- Doracak Trajnimi për Avokatët në Fushën e Drejtësisë për Fëmijë.

36. Nga aktet që ndodhen në dosjen e kandidimit rezultojn se kandidatja Holta Zaçaj, ka vetëdeklaruar në jetëshkrim punime, për të cilat nuk është paraqitur dokumentacion provues, (përveç dokumenteve të përmendur në paragrafin e mësipërm), si më poshtë:

- Protokoll i përbashkët Bashkëpunimi ndërmjet Odës së Avokatëve të Kosovës, Agjencisë për Ndhimën Juridike Falas, Zyrës për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave
Bashkëautore
Periudha: Viti 2015
Detyra: Hartimi i një protokoll referues për forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional mes Dhomës së Avokatisë për Ndhimën Juridike falas dhe Divizionit për Mbrojtjen e Viktimave me qëllim dhënie të një ndihme ligjore dhe trajtim profesional për fëmijët në kontakt me ligjin.
- Doracak Trajnimi për Avokatët, mbrojtësit e viktimave dhe zyrtarët për ndihmën juridike falas në fushën e drejtësisë për fëmijë
Bashkëautore
Periudha: Viti 2015
Detyra: Oda e Avokatëve të Kosovës, UNICEF, Zyra e BE në Kosovë.
Manual trajnimi për avokatët, mbrojtësit e viktimave dhe zyrtarët e ndihmës juridike falas e drejtësisë për fëmijë.
- Raport mbi Mangësitë dhe sfidat kryesore për përmirësimin e aksesit në të drejta dhe në sistemin e drejtësisë së fëmijëve nga komunitete të marginalizuara me fokus të veçantë komunitetin rom.

- Autore kryesore
 Periudha: Viti 2013
 Kontraktorë: UNICEF, Save the Children, QSHPLI dhe Terre des Hommes.
- Revista Bankieri – Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave.
 Artikulli: Kolaterali financiar, një risi në të drejtën shqiptare dhe sfidat e zbatimit të tij.
 Periudha: Korrik 2013
 - Procedura standarde pune për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake.
 Bashkëautore
 Periudha: 2012-2013
 Kontraktorë: QSHPLI, UNICEF, Terre des Hommes, Save the Children
 Subjekti: Procedurat standarde të punës për trajtimin e të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake, miratuar me Urdhër nr. 300, datë 8.7.2013 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
 - Doracak Trajnimi për Avokatët në fushën e drejtësisë për fëmijë
 Bashkëautore
 Periudha: Viti 2012
 Kontraktorë: Oda e Avokatëve të Kosovës, UNICEF, Zyra e BE-së Kosovë
 Subjekti: Manual trajnimi për avokatët e angazhuar në dhënien e ndihmës ligjore falas për të miturit në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal.
 - Hartëzimi dhe Vlerësimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Republikën e Kosovës.
 Bashkëautore
 Periudha: Viti 2012
 Kontraktorë: UNICEF, Zyra e BE-së Kosovë
 Subjekti: Hartëzimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës, me qëllim dhënien e rekomandimeve për krijimin e një sistemi koherent dhe bashkëveprues të strukturave shtetërore të përfshira në mbrojtjen e fëmijës.
 - Manual për Avokatët mbi Zbatimin e Kodit të Familjes dhe Legjislacionit Civil në Lidhje me Çështjet për të Miturit.
 Bashkëautore
 Periudha: Viti 2011
 Kontraktorë: QSHPLI, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
 - Protokollin e punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve.
 Periudha: Viti 2010
 Kontraktorë: Terre des Hommes Misioni në Shqipëri, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe UNICEF në Shqipëri.
 Subjekti: Protokollin është një udhëzues praktik për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve me qëllim dhënien e një kujdesi të vazhdueshëm dhe tërësor për fëmijën duke parashikuar instrumente për matjen e rrezikut dhe masat përkatëse që duhet të ofrohen nga aktorët e përfshirë në mbrojtjen e fëmijës.
 - Manual mbi standardet e Shërbimit të Provës.
 Autore kryesore
 Periudha: Qershor-Dhjetor 2009
 Subjekti: Manuali do të përdoret si një mjet trajnimi dhe një mjet praktik nga oficerët e provës, gjyqtarë dhe prokurorë të kontraktuar nga UNICEF, Shqipëri dhe Shërbimin e Provës.
 - Raporti alternativ i Konventës së OKB për të drejtat e fëmijëve.
 Autore kryesore
 Periudha: 2005-2009
 Kontraktorë: UNICEF dhe Aleanca e Fëmijëve (Koalicioni Shqiptar i Organizatave Joqeveritare).

Subjekti: Kryerja e një analize krahasuese të standardeve të KDF me legjislacionin dhe praktikën shqiptare bazuar në kërkesat e raportimit, udhëheqjen dhe procesin e konsultimit me OJQ dhe anëtarët e tjerë të ekipit. Raporti është prezantuar zyrtarisht në Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë.

- Ekzekutimi i detyrimeve monetare sipas vendimeve gjyqësore në llogaritë bankare sipas modelit italian.

Konsulente

Periudha: Viti 2009

Kontraktore: Banka Botërore, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, AMF, Shoqata e Bankave.

Subjekti: Shënime mbi Eksperiencën italiane për zbatimin e detyrimit monetar për shkak të vendimeve gjyqësore në llogaritë bankare.

- Analiza e alternativave për ekzistencën e Depozitarit Qendror të titujve, Shërbimet e depozitimit për emetuesit dhe investitorët shqiptarë duke krahasuar opsionet e themelimit të një qendre të re kundrejt blerjes së shërbimeve të depozitarit.

Konsulente

Periudha: Viti 2009

Kontraktore: Banka Botërore, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, AMF, Shoqata e Bankave.

- Manual mbi zbatimin e Kodit të Familjes dhe legjislacionit civil në lidhje me çështjet për të miturit.

Bashkëautore

Periudha: Viti 2008

Kontraktorë: Shkolla e Magjistraturës dhe Save the Children, Shqipëri

Subjekti: Analizë ligjore krahasuese për të drejtat e fëmijëve dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e aftësisë juridike të fëmijëve, martesën e të miturve, kujdestarinë, dhunën në familje, detyrimin ushqimor të fëmijës, të drejtat dhe përgjegjësitë prindërore, përgjegjësia prindërore në rastet e divorcit, birësimi. Manuali është një dokument trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët.

- Manual "Intervistimi i të miturve nga punonjësit e policisë".

Bashkëautore

Periudha: Viti 2008

Kontraktorë: QSHPLI, Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Subjekti: Manual trajnimi për punonjësit e policisë, në lidhje me procesin dhe teknikat e intervistimit të të miturve.

- Studim krahasues përputhshmëria e legjislacionit shqiptar me Konventën e OKB për të drejtat e fëmijëve.

Bashkëautore

Periudha: Tetor 2006-Shtator 2008

Kontraktorë: Save the Children dhe Swedish International Development Agency

Subjekti: Analiza e parë ligjore gjithëpërfshirëse dhe shteruese mes legjislacionit shqiptar dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

- Studim krahasues mbi implementimin e Konventës së OKB mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Bashkëautore

Periudha: Viti 2007

Kontraktorë: UNICEF, Shqipëri

Subjekti: Studimi është përqendruar mbi ekzaminimin e plotë krahasues të legjislacionit shqiptar dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian, në kuadër të procesit të stabilizim-asocimit, me standardet e Konventës së OKB për të drejtat e personave me Aftësi të Kufizuar.

- Manual për avokatin mbrojtës të të miturit “Të mbrosh të miturin”.
Bashkëautore
Periudha: Viti 2007
Kontraktorë: QSHPLI, Swedish International Development Agency, UNICEF Shqipëri
Subjekti: Udhëzues për avokatët si të mbrojnë fëmijët në çështjet penale dhe civile, një manual i përdorur nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për trajnimin e avokatëve.
- Revista “E drejta parlamentare dhe politikat ligjore”. Botimi i Qendrës së Studimeve Parlamentare.
Artikull: Pozicioni i fëmijës në Kodin e ri të Familjes
Periudha: Viti 2003
- Përmbledhje e kornizës ligjore të drejtësisë për të miturit.
Anëtar i Grupit të Punës
Periudha: Shtator-Dhjetor 2002
Kontraktorë: Ministria Shqiptare e Drejtësisë mbështetur nga UNICEF
Subjekti: Përmbledhje ligjore me komentare për të gjitha kategoritë e profesionistëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë për të miturit në Shqipëri.
- Raport mbi standardet e të drejtave të njeriut në komisariatet e policisë.
Bashkëautore
Periudha: Qershor-Gusht 2002
Kontraktor: UNICEF

37. Mbështetur në këto të dhëna të rezultateve në ushtrimin e detyrës, si dhe në tematikën e përmbajtjen e produkteve profesionale të lidhura me ushtrimin e detyrës apo edhe me ushtrimin e profesionit, Këshilli vlerëson se *në aspektin sasior* kandidatja Holta Zaçaj ka tregues të lartë angazhimi profesional, i cili rezulton të jetë mbi atë që mund të gjykohej si një angazhim i zakonshëm apo “mesatar” në ushtrimin e profesionit. Për këto arsye, Këshilli çmoi ta vlerësojë kandidaten Holta Zaçaj për këtë kriter ligjor vlerësimi me **2,77 (dy presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.

38. Për sa i përket *vlerësimit cilësor*, Këshilli shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Holta Zaçaj, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, me synimin për të evidentuar, bazuar në tregues shkencorë, elementë që dëshmojnë arritjen e rezultateve profesionale, shkallën e këtyre arritjeve, përfshirë elementë që nga këto dokumente profesionalë dhe në tërësi nga veprimtaria profesionale e kandidatit dëshmojnë spikatjen dhe dallueshmërinë e tij në kuptimin dhe qëllimin për të cilin Kushtetuta dhe ligji e përcakton si kusht për vlerësimin e kandidaturës për këtë Këshill dhe, më tej, për përzgjedhjen e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetues nga organet e emërtesës.

39. Në veprimet përgatitore të kryera gjatë procedurave të verifikimit të kandidaturës, në datën 25.07.2022, kandidatja Holta Zaçaj ka njoftuar Këshillin me shkrim se për qëllimet e procedurës së vlerësimit në kuadër të pikëzimit për “Kualifikimin e Përgjithshëm Profesional” dhe “Kualifikimin Shtesë Profesional”, ka përzgjedhur pesë dokumente, të cilët janë botime shkencore si më poshtë:

- Manual mbi zbatimin e Kodit të Familjes dhe legjislacionit civil në lidhje me çështjet për të miturit;
- Raporti Alternativ i Konventës së OKB për të Drejtat e Fëmijëve;
- Manual “Intervistimi i të Miturve nga Punonjësit e Policisë”;
- Hartëzimi dhe vlerësimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve në Republikën e Kosovës;
- Doracak Trajnimi për Avokatët në Fushën e Drejtësisë për Fëmijë.

40. Në lidhje me tërësinë e dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Holta Zaçaj dhe në veçanti, lidhur me pesë dokumentet profesionale të sipërcituara, për realizimin e vlerësimit profesional dhe të pikëzimit përkatës për këtë kriter ligjor vlerësimi. Këshilli shqyrtoi dhe bisedoi në mënyrë të posaçme dhe të kujdesshme përmbajtjen e tyre, duke u mbështetur mbi indikatorë shkencorë, sikurse janë edhe ato të përmendura në Shtojcën nr. 1 të vendimit sipas vendimit nr. 5 datë 02.04.2019, të këtij Këshilli, si edhe orientime që përmbahen në Metodologjinë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51, datë 21.06.2019.

41. Dokumentet profesionale të shqyrtuara trajtojnë tematika të ndryshme që lidhen me: *fushën e të drejtave të njeriut me një fokus të veçantë në të drejtat e fëmijëve (duke u shtrirë dhe në Republikën e Kosovës), parë këto të drejta në aspekte të ndryshme, qoftë brenda familjes, apo në caktimin e kujdestarisë, ashtu edhe në rastin kur të miturit përballen në cilësi të ndryshme me ligjin penal dhe institucionet përkatëse ligjzbatuese. Po ashtu në vëmendje të këtyre dokumenteve kanë qenë dhe fëmijët nga komunitete të marginalizuara me fokus të veçantë komunitetin rom. Nga kandidatja, në punimet e saj profesionale janë trajtuar tematika mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, standardet e Shërbimit të Provës, si dhe mbi aspekte të ndryshme në të drejtën bankare.*

42. Njëri ndër indikatorët vlerësues të dokumenteve profesionale është *“Origjinaliteti dhe ose impakti (duke përfshirë kontrollin për plagjiaturë) të dokumentit”*. Nisur nga profili profesional dhe angazhimi shkencor i kandidates Holta Zaçaj, përmbajtja e dokumenteve të përzgjedhura, dobisë së përdorimit të tyre nga profesionistë të fushës por edhe nga grupe interesi dhe publiku i gjerë, Këshilli vëren se publikimet dhe artikujt e analizuar dëshmojnë qasje profesionale origjinale veçanërisht mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuar, personave në konflikt me ligjin, apo për aspekte të ndryshme në të drejtën bankare, çështje për të cilat jo vetëm në kohën e publikimit, por edhe aktualisht ka një nevojë të veçantë për njohje dhe zbatim.

43. Këshilli, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Origjinaliteti dhe/ose impakti”*, duke marrë në konsideratë faktin se nuk ka të dhëna për plagjiaturë të dokumentit, vjen në përfundimin se lidhur me këtë tregues vlerësimi kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet me **4,89 (katër presje tetëdhjetë e nëntë) pikë**.

44. Për sa i përket treguesit vlerësues të lidhur me *“Aftësitë analitike”*, Këshilli vëren se posaçërisht pesë dokumentet profesionale të shqyrtuara, sikurse edhe në rastin e publikimeve dhe artikujve profesionale, kandidatja Holta Zaçaj tregon zotërimin e aftësive të larta për të analizuar informacionin dhe për të identifikuar, arsyetuar dhe zbatuar konceptet ligjore, parimet dhe institutet e së drejtës, sipas natyrës dhe qëllimit të vetë këtyre punimeve.

45. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin *“Aftësitë analitike”*, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet me **4,55 (katër presje pesëdhjetë e pesë) pikë**.

46. Në lidhje me treguesin vlerësues *“Aftësitë kërkimore”*, Këshilli shqyrtoi veçanërisht pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Holta Zaçaj, sikurse edhe publikimet dhe artikujt profesionale, të paraqitur në dosjen e kandidatit. Nga ky shqyrtim, Këshilli vëren se këto punime përmbajnë informacione të lidhura me fusha të larmishme të së drejtës, kryesisht me të drejtat e njeriut dhe rolin e Avokatit të Popullit për promovimin dhe mbrojtjen e tyre, të dhënat personale të individit dhe parandalimin e torturës. Për arritjen e lëndës së

trajtuar dhe qëllimin e trajtimit shkencor, nga përmbajtja e secilit prej punimeve të shqyrtuara. adresohen analiza krahasimore duke përdorur burime të ndryshme të doktrinës dhe praktikës gjyqësore, vendase dhe ndërkombëtare.

47. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Aftësitë kërkimore*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet me **3,77 (tre presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.

48. Për treguesit “*Saktësia dhe precizoni*”, në thelb, u verifikua nëse në veprimtarinë profesionale të kandidatit janë mbuluar me profesionalizëm tematika e përzgjedhur dhe materiali ka shmangur përsëritjet apo citimet e panevojshme etj.. Nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Holta Zaçaj, Këshilli vëren se këto punime tregojnë nivel të lartë të parashtrimit të problemeve juridike për analizë dhe zgjidhje, përdorim korrekt të terminologjisë juridike dhe të gjetjeve nga legjislacioni, doktrina, si edhe praktika gjyqësore.

49. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Saktësia dhe precizoni*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet me **4,78 (katër presje shtatëdhjetë e tetë) pikë**.

50. Në lidhje me treguesin vlerësues “*Qartësia*”, Këshilli shqyrtoi pesë dokumentet profesionale të përzgjedhura nga kandidatja Holta Zaçaj. Këshilli vëren se këto punime janë të organizuara dhe strukturuar në mënyrën e duhur, gjuha e përdorur është e pasur dhe profesionale. Qartësia e gjuhës së përdorur dhe strukturimi i materialit i bëjnë këto punime të kuptueshme dhe të lexueshme, sipas natyrës së punimit dhe grupeve të interesit të cilave synon ti drejtohet.

51. Për rrjedhojë, pas shqyrtimit dhe analizës mbi dokumentacionin profesional të paraqitur, në lidhje me treguesin “*Qartësia*”, Këshilli vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet me **3,78 (tre presje shtatëdhjetë e tetë) pikë**.

52. Këshilli, pasi shqyrtoi të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja Holta Zaçaj, veçanërisht pesë prej dokumenteve të përzgjedhura prej saj, për sa i përket vlerësimit cilësor, vjen në përfundimin se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet në total me **21,77 (njëzet e një presje shtatëdhjetë e shtatë) pikë**.

A. Meritat profesionale – Kualifikimi Shtesë Profesional

53. Në shkronjën “b” të pikës 2 dhe shkronjën “b” të pikës 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në vendimin nr. 5 datë 02.04.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të nxjerrë në bazë e për zbatim të ligjit, në lidhje me kualifikimin e shtesë profesional, përcaktohen si kritere vlerësimi që kandidatët të kenë veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe në sfera të tjera të së drejtës, vlerësim të dallueshëm të rëndësisë së punimeve akademike, studimeve shkencore, shkrimeve dhe ligjëratave profesionale, botimeve, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, përvojë të veçantë në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë, si edhe pjesëmarrje të dallueshme në procesin e hartimit ose të konsultimit të legjislacionit dhe çdo angazhim tjetër profesional të kandidatit përgjatë 5 viteve të fundit në fushën e së drejtës.

54. Prandaj, në zbatim të ligjit, në varësi edhe të profileve dhe karrierave profesionale të secilit kandidat, nga totali prej 12 pikësh për këtë kategori vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 8 pikë ekspertizën në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizën në fusha të tjera të veçanta të së drejtës. Gjithashtu, Këshilli vlerëson deri në 4 pikë angazhimet profesionale shtesë të kandidatëve. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

Specializimi në të drejtën kushtetuese, të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës

55. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose ekspertizës në fusha të tjera të veçanta të së drejtës*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumente të tjera zyrtare mbi rezultate të vlerësimit profesional etj., si edhe nga shqyrtimi i dokumenteve profesionale të paraqitura nga kandidatja Holta Zaçaj, Këshilli i rezulton se karriera profesionale e kësaj kandidateje është fokusuar në pjesën dërmuese të kohëzgjatjes dhe shtrirjes në fushën e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe drejtësisë kushtetuese, si lektor, ekspert ligjor dhe koordinator në projekte, kombëtare dhe ndërkombëtare.

56. Këshilli vëren se në formimin profesional, specializimin dhe ekspertizën e posaçme profesionale të fituar nga kandidatja Holta Zaçaj, një rol të veçantë ka edhe interesi i treguar vetjak profesional për ushtrimin e vazhdueshëm të veprimtarive profesionale si Pedagoge në lëndët “E drejtë familjare”, “E drejtë bankare”, “E drejtë financiare etj.. pranë Shkollës së Magjistraturës dhe pranë disa Universiteteve Jopublike, apo dhe si trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës.

57. Së fundmi, si rrjedhojë dhe reflektim i përgatitjes profesionale dhe përvojës së fituar, kandidatja Holta Zaçaj në cilësinë e autorit ka realizuar punime profesionale dhe artikuj shkencore, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të cilat në pjesën më të madhe të tyre, trajtojnë aspekte të ndryshme të së drejtës, veçanërisht e lidhur me njohjen, respektimin dhe mbrojtjen e lirive themelore e të drejtave të njeriut, por jo vetëm.

58. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“ekspertizës në të drejtën kushtetuese dhe në të drejtat e njeriut ose në fusha të tjera të së drejtës”* Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidates Holta Zaçaj **7,2 (shtatë presje dy) pikë**.

Angazhime profesionale shtesë

59. Nga akti dokument i jetëshkrimit të kandidatit që ndodhet në dosjen e kandidimit rezulton se kandidatja Holta Zaçaj, deklaron se ka pasur këto angazhime të tjera profesionale:

- Ekspert ligjor i Programit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian
Periudha: Janar-Korrik 2020
Studimi mbi rritjen e eksedit në ndihmën juridike për fëmijët në konflikt me ligjin-një pasqyrë e përgjithshme e kuadrit ligjor që rregullon ndihmën juridike në Shqipëri me theks të veçantë tek fëmijët, aksesit i tyre në drejtësi dhe në të drejtat.
- Ekspert ligjor i UNICEF Zyra e Kosovës
Periudha: Prill-Qershor 2019
Hartimi dhe vlerësimi i shërbimeve për fëmijët në konflikt me ligjin.

- Ekspert ligjor i Këshillit të Evropës
Periudha: Shkurt 2017-Dhjetor 2018
Hartimi i udhëzimeve për vlerësimin e moshës dhe vendosjen në kujdestari.
- Ekspert ligjor i Këshillit të Evropës (CAHEN, Masat mbrojtëse të fëmijëve)
Periudha: Shkurt -Dhjetor 2017
Hartimi i një udhëzuesi të ri mbi vlerësimin e moshës dhe kujdestarinë, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Shqipërisë
Periudha: Tetor 2015-Janar 2017
Hartimi i ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Kosovës
Periudha: Shtator 2015-Maj 2017
 - (a) Hartimi i paketës ligjore për institucionet korrektuese, gjysëm të hapura për fëmijët në konflikt me ligjin dhe kurrikulës së trajnimit për punonjësit e tyre;
 - (b) Hartimi i Strategjisë për ekzekutimin e sanksioneve penale;
 - (c) Ofrimi i trajnimeve për OJQ-të në Kosovë mbi hartimin e një modeli Raporti Alternativ për Konventën e OKB-së mbi të drejtët e fëmijëve.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Shqipërisë
Periudha: Nëntor 2015-Qershor 2016
Analiza ligjore për mekanizmat, masat dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës në Kodin e Familjes dhe vlerësimin e nevojës për hartimin e akteve nënligjore në lidhje me vendosjen e fëmijëve në kujdestari tek familjet kujdestare.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Kosovës
Periudha: 19-23 Tetor 2015
Analizë e përmbledhur e gjetjeve kryesore mbi situatën e të miturve me Masa Edukative.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Kosovës
Periudha: Shtator 2010-Qershor 2011
Hartëzimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve bazuar në paketën e re të Instrumenteve matës të UNICEF.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Shqipërisë
Periudha: Janar 2013-Qershor 2013
Hartimi i kapitullit të ri të Kodit të Procedurës Penale për të Mitur.
- Ekspert ligjor i UNICEF, Zyra e Gjeorgjisë
Periudha: Janar-Maj 2010
Përgatitja dhe kryerja e një programi trajnimi për avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë mbi aftësitë dhe instrumentet e gjykimit në çështjet civile nga këndvështrimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- Specialist në Grupin e Punës të Këshillit të Evropës
Periudha: Shkurt-Dhjetor 2009
Hartimi i Udhëzimeve të Këshillit të Evropës për Drejtësinë Miqësore për Fëmijët, miratuar nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. Udhëzimet e miratuara shërbejnë si një mjet praktik për shtetet anëtare në adaptimin e sistemeve të tyre gjyqësore për të drejtat, interesat dhe nevojat specifike të fëmijëve dhe të të rinjve.
- Ekspert ligjor-Kuvendi i Shqipërisë/Komisioni i Ligjeve
Periudha: Janar 2002-Prill 2003
Hartimi i amendimeve mbi draftin e parë të Kodit të Familjes të Shqipërisë, pjesa e kujdestarisë.

60. Nga kandidatja nuk janë paraqitur certifikata sa i përket angazhimeve profesionale të sipërpërmendura dhe të deklaruara nga vetë ajo (kandidatja).

61. Gjithashtu, nga kandidatja është paraqitur dokument i përkthyer dhe njëzuar me origjinalin, i lëshuar më 30 Nëntor 2018, nga Gjykata Supreme e mbajtur në Boston, në dhe për kontenë e Suffolk, si Gjykata më e Lartë e regjistrimeve në Komënuelthin e Masaçusetsit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas të cilit: *“Holta Zaçaj pasi u konstatua e kualifikuar rregullisht në emër të saj, dhe pasi ka marrë dhe nënshkruar betimet e kërkuara nga ligji, u pranua të ushtrojë profesionin e avokatit dhe në bazë të kësaj, si këshilltar juridik në çdo Gjykatë të Komënuelthit në fjalë.”*. Sa më sipër është dëshmuar e nënshkruar dhe vulosur nga kancelari i kësaj gjykate.

62. Nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista dhe dokumentet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidimit, rezulton se kandidatja Holta Zaçaj, krahas periudhës të përlllogaritur si vjetërsi në profesion, ka ushtuar edhe veprimtari profesionale shtesë si lektor me kohë të pjesshme dhe trajnuese pranë shkollës së magistraturës dhe në disa universitete jopublike, pjesëmarrës në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, ekspert ligjor në projekte të ndryshme me fokus çështje të të drejtave të fëmijëve dhe të drejtë financiare e bankare. Këto angazhime shtesë profesionale janë të lidhura me kontribute dhe pjesëmarrje në përgatitjen e analizave ligjore dhe studimeve mbi çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut etj..

63. Prandaj, duke pasur parasysh këto angazhime shtesë profesionale, të shtrira në kohë dhe me kontribute konkrete profesionale në disa nga fushat më të rëndësishme të së drejtës, Këshilli vlerëson që për kriterin vlerësues të *“angazhimeve profesionale shtesë”*, t'i caktojë kandidates Holta Zaçaj **3,44 (tre presje dyzet e katër) pikë**.

Meritat Morale

64. Në shkronjën “c” të pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 si kriter vlerësimi është përcaktuar që kandidatët të jenë vlerësuar për *“integritetin etik e moral”*. Po kështu, në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 240 të ligjit nr. 115/2016 përcaktohen si kriter *“Rezultatet e vlerësimit të etikës së kandidatëve gjatë punës, nëse ka”*, ndërsa në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni përcaktohen si kriter vlerësimi edhe *“Reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve”* dhe *“cilësitë morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi”*. Së fundi, në shkronjën “c” parashikohet si kriter vlerësimi edhe *“angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile”*. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kriter vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kriterëve.

65. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat morale, nga totali prej 30 pikësh për të tre komponentët vlerësues, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 18 pikë *integritetin etik dhe moral*, deri në 10 pikë *reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve* dhe deri në 2 pikë *angazhimin e provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

66. Në lidhje me “meritat morale”, krahas të dhënave që rezultojnë nga jetëshkrimi, mbahen parasysh edhe gjetjet në procedurën e verifikimit të kandidatit, ku përmbahen të dhëna që kanë të bëjnë apo mund të përdoren për efekte të vlerësimit të integritetit etik e moral të kandidatit, angazhime në kauza të shoqërisë civile etj.. Gjithashtu, për këtë komponent të vlerësimit mbahen parasysh edhe të dhëna e përfundime që mund të nxirren gjatë intervistës së kandidatit me Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

67. Nga kandidatja në datë 21.12.2021 në lidhje me këtë kriter janë dorëzuar dokumente që kanë të bëjnë me vlerësime të marra nga kandidatja nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri (Certifikatë vlerësimi për kontribut, angazhim profesional dhe udhëheqje në emër të Shqipërisë (8 mars 2002) dhe nga Transparency International dhe UNICEF (Çmimi i mirënjohjes për kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë në Reformën në Drejtësi në Shqipëri (viti 2009), si dhe referenca mbi cilësitë personale dhe profesionale të kandidatit nga bashkëpunëtorë të tij në veprimtaritë e ndryshme profesionale, vendas dhe të huaj.

68. Në rastin e kandidates Holta Zaçaj, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve në intervistë, motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave morale të kësaj kandidateje.

Integriteti etik e moral

69. Për sa i përket kriterit të parë vlerësues, *integritetit etik e moral*, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga të dhëna të tjera të disponueshme, Këshilli i rezulton se kandidatja Holta Zaçaj në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj tregon angazhim të ndërgjegjshëm në përmbushjen e detyrave profesionale dhe në ushtrimin e profesionit, si edhe vëmendje për t’iu përgjigjur me kujdesin e duhur pyetjeve të cilat i drejtohen nga bashkëbiseduesit.

70. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*integritetit etik e moral*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidates Holta Zaçaj **17,33 (shtatëmbëdhjetë presje tridhjetë e tre) pikë**.

Reputacionin që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve

71. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht, Këshilli i rezulton se kandidatja Holta Zaçaj në veprimtarinë, sjelljen dhe komunikimin e saj nuk heziton të tregojë angazhim në përmbushjen e detyrave të saj. Sipas të dhënave që disponohen, Këshilli i rezulton se kandidatja Holta Zaçaj reflekton përgjegjshmëri në angazhimet e saj profesionale.

72. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të “*reputacioni që gëzon kandidati në shoqëri dhe midis kolegëve*” Këshilli vlerëson t’i caktojë kandidates Holta Zaçaj **9,44 (nëntë presje dyzet e katër) pikë**.

Angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile

73. Për sa i përket kriterit të dytë vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*”, nisur nga të dhënat që rezultojnë nga jetëshkrimi, motivimi për kandidim, intervista, komunikimi i kandidatit me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe nga dokumente të tjera zyrtare apo të aksesueshme publikisht. Këshilli i rezulton se, kandidatja Holta Zaçaj ka qenë e angazhuar në veprimtari të tjera profesionale, në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile. Nga jetëshkrimi dhe aktet e dosjes së kandidimit rezulton se kandidatja Holta Zaçaj, në një pjesë të konsiderueshme të aktivitetit profesional ka qenë në cilësinë e ekspertit ligjor e kontraktuar brenda dhe jashtë vendit nga organizata jofitimprurëse kryesisht ndërkombëtare, si dhe, sipas shkresës që i është dërguar KED nga organizata jofitimprurëse Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, ka qenë drejtuese e kësaj qendre për periudhën Prill 2004-Prill 2007.

74. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile*” Këshilli vlerëson kandidaten Holta Zaçaj me **2 (dy) pikë**.

Meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale

75. Në nenin 240 të ligjit nr. 115/2016 parashikohen si kritere vlerësimi disa komponentë të lidhura me aftësitë profesionale dhe personale të kandidatëve mbi çështjet e natyrës drejtuese, organizative, të kapacitetit për vendimmarrje, punës në grup, të komunikimit dhe përfaqësimit publik. Kështu, në pikën 3 të këtij neni parashikohen kriteret vlerësuese për kandidatët si më poshtë:

“a) cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin”;

b) aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore;

c) aftësitë e komunikimit;

ç) aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;

d) aftësitë e përfaqësimit publik.”

76. Në bazë dhe për zbatim të ligjit, lidhur me këto kritere vlerësimi, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nxjerrë vendimin normativ nr. 5, datë 02.04.2019, ku përcaktohen rregullime më të hollësishme si edhe shpërndarja e pikëve të vlerësimit sipas peshës specifike të këtyre kritereve.

77. Prandaj, në zbatim të ligjit, lidhur me meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale, nga totali prej 10 pikësh për të pesë komponentët vlerësues të sipërcituar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson deri në 3 pikë *cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin* kandidatët, deri në 4 pikë *aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore*, deri në 2 pikë *aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik*, si edhe me 1 pikë për *aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore*. Në arsyetimin dhe përfundimet e tij, Këshilli mban parasysh rregullat e hollësishme të përcaktuara me vendimin normativ nr. 5 datë 02.04.2019 të këtij Këshilli dhe Shtojcën nr. 1 të tij, si edhe orientimet në përcaktimin e pikëve përkatëse të merituar sipas Metodologjisë për vlerësimin dhe caktimin e pikëve për renditjen e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të miratuar me vendimin nr. 51 datë 21.06.2019.

78. Në rastin e kandidatës Holta Zaçaj, krahas jetëshkrimit, paraqitjes dhe sjelljes gjatë parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së motivimit për kandidim dhe historikut të komunikimit të kandidatit me Këshillin gjatë procesit të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, si edhe çdo të dhënë a dokument tjetër të aksesueshëm publikisht nëpërmjet të cilave mund të nxirreshin elementë të dobishëm për qëllimet e verifikimit dhe vlerësimit të meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale të këtij kandidati.

Cilësia e platformës dhe të vizionit

79. Këshilli shqyrtoi përmbajtjen e dokumentit me shkrim, platformës mbi motivimin e kandidimit dhe vizionit të kandidatës Holta Zaçaj lidhur me qasjen dhe qëndrimet e saj mbi rëndësinë dhe aspektet thelbësore të ushtrimit të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, mbi sfidat kryesore me të cilat është përballur dhe duhet të përballlet Gjykata Kushtetuese në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Gjithashtu, në vlerësimin e këtij kriteri, Këshilli mban parasysh edhe parashtrimet dhe shpjegimet e dhëna nga ky kandidat gjatë intervistës dhe në përgjigje të pyetjeve që iu drejtuan nga anëtarët e Këshillit.

80. Nisur nga dokumenti me shkrim dhe shpjegimet e paraqitura gjatë intervistës, Këshilli vëren se kandidatja Holta Zaçaj ka njohuritë mbi rëndësinë e misionit, kërkesave etike morale dhe profesionale që dikton pozicioni i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese si edhe të kësaj Gjykate, në respektimin e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut dhe në tërësi të mirëfunksionimit të sistemit demokratik dhe shtetit ligjor. Gjithashtu, kjo candidate parashtrroi aftësitë dhe përkushtimin e tij për përmbushjen e misionit të Gjykatës Kushtetuese.

81. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues “*cilësia e platformës dhe të vizionit të paraqitur*” Këshilli vlerësoi t’i caktojë kandidatës Holta Zaçaj **3 (tre) pikë**.

Aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

82. Lidhur me aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi, Këshilli mbështetet pikësisht në të dhënat që lidhen me përvoja konkrete nga karriera e kandidatëve në funksione dhe pozicione të cilat kërkojnë dhe tregojnë marrjen përsipër të përgjegjësive dhe ushtrimin e vendimmarrjes në ushtrimin e kompetencave dhe përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Gjithashtu, në vlerësimin e kandidatëve për këtë komponent vlerësimi, Këshilli mban parasysh se ushtrimi i çdo detyre, funksioni dhe veprimtarie profesionale, edhe kur formalisht nuk lidhet drejtpërdrejt me të drejtën/detyrimin për ushtrimin e kompetencës vendimmarrëse, gjithsesi përmban elementë që tregojnë aftësi të provuara ose premtuese për të marrë nisma, për të kërkuar zgjidhje, për të marrë përgjegjësitë si edhe vendimet e duhura e në kohën e duhur sipas përcaktimeve të ligjit dhe në përgjigje të ndjeshmërisë së publikut.

83. Në rastin e kandidatës Holta Zaçaj, krahas jetëshkrimit, parashtrimeve dhe bisedës në intervistë, përmbajtjes së platformës dhe motivimit për kandidim, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrtoi të dhënat nga dokumentet profesionale, si edhe aktet e tjera zyrtare të administruara në dosjen e kandidatit, për të evidentuar të dhëna në lidhje me aftësitë e provuara apo premtuese të këtij kandidati për të marrë vendime dhe përgjegjësi edhe në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

84. Këshilli vëren se kandidatja Holta Zaçaj, në karrierën e saj profesionale ka ushtruar veprimtari profesionale të natyrës drejtuese dhe bashkërenduese. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“aftësitë e provuara për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore”*. Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatës Holta Zaçaj **2,88 (dy presje tetëdhjetë e tetë) pikë**.

Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik

85. Aftësitë e komunikimit, në të gjitha format, sikurse edhe në përfaqësimin publik e me të tretët, të shprehurit në mënyrë të qartë, lehtësisht të kuptueshme, të matur, me respekt dhe në mënyrë jodiskriminuese, luajnë një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

86. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, mënyra dhe stili i parashtrimeve me shkrim të platformës, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga përmbajtja, strukturimi dhe stili i hartimit të dokumenteve profesionale të administruara në dosjen e kandidatës, Këshilli vëren se kandidatja Holta Zaçaj zotëron aftësi të mira për të komunikuar me kujdesin e duhur, për të dëgjuar me profesionalizëm dhe për t'u përgjigjur në lidhje me të gjitha çështjet dhe problematikat që vlerëson të trajtohen, ashtu edhe për çështje dhe problematika që ngrihen nga të tjerët.

87. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues të *“Aftësitë e komunikimit dhe aftësitë e përfaqësimit publik”*, Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatës Holta Zaçaj **2 (dy) pikë**.

Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale

88. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, për vetë natyrën e këtij funksioni, mënyrës së funksionimit dhe kolegjalitetit të kërkuar në veprimtarinë e vendimmarrjen kësaj Gjykate, duhet të zotërojë aftësitë e duhura për një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë i përfshirë në punën në grup, me gjyqtarët e tjerë, këshilltarët dhe anëtarët e stafit të Gjykatës. Pjesë e kësaj aftësie është edhe nevoja për t'u përshtatur shpejt me zhvillimet e reja, si edhe ndaj nevojës për t'u përfshirë në veprimtari në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore gjatë karrierës gjyqësore.

89. Nga shqyrtimi i jetëshkrimit, sjellja, mënyra e komunikimit dhe argumentimit gjatë bisedës në intervistë, si edhe nga dokumentet profesionale të administruara në dosjen e kandidatit. Këshilli vëren se kandidatja Holta Zaçaj zotëron aftësi shumë të mira për të punuar në grup dhe ka të dhëna të qarta në drejtim të organizimit të veprimtarive në ambiente multikulturale dhe multidisiplinore. Prezantimi dhe dokumentet profesionale dëshmojnë se kjo candidate është përfshirë vijimësisht në projekte profesionale me kolegë të tjerë, vendas apo të huaj, për realizimin e veprimtarive, publikimeve shkencore dhe artikujve profesionalë.

90. Gjithashtu, zotërimi i këtyre aftësive rezulton i reflektuar edhe në vetë mënyrën e parashtrimit me shkrim të çështjeve në platformën e paraqitur, si edhe në komunikimin e bisedën e zhvilluar me Këshillin gjatë intervistës.

91. Prandaj, në lidhje me kriterin vlerësues *“Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale”*, Këshilli vlerëson t'i caktojë kandidatës Holta Zaçaj **1 (një) pikë**.

92. Në përfundim të arsytimit mbi mënyrën dhe shkallën e vlerësimit për të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga ligji dhe të pikëzimit përkatës të treguar më sipër në këtë Vendim, në funksion të procedurave ligjore të përzgjedhjes së gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për efekt të renditjes së kandidatëve për vendet vakante në të cilat ka kandiduar, Këshilli të Emërimeve në Drejtësi i rezulton se kandidatja Holta Zaçaj vlerësohet në total me 82.2 **(tetëdhjetë e dy presje dy) pikë.**

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577/2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019, “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

VENDOSI:

1. Vlerësimin e kandidates Holta Zaçaj, me 82.2 **(tetëdhjetë e dy presje dy) pikë** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe datë 15.11.2021.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidates Holta Zaçaj.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETAR

Sokol BINAJ

